



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 47 (827799)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 25 nëntor 2022

Gjeneral brigade Arben Kingji, takim me ambasadoren Yuri Kim

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim ambasadoren amerikane në Tiranë, Yuri Kim. Në këtë takim ata diskutuan mbi forcimin marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes mes SHBA-së dhe Shqipërisë. Ata ranë dakord të rrisin bashkëpunimin në

vazhdim të stërvitjes historike "Defender Europe 2021", dhe në përgatitje për stërvitjet e ardhshme "Defender Europe 2023". Të dy diskutuan ndikimin pozitiv të selisë së Komandës së Forcave Operacionale Speciale të SHBA-ve (SOCEUR), në Shqipëri dhe aktivitetet e Brigadës së For-

cave të Sigurisë dhe të Ndihmës së Ushtrisë së SHBA-ve (SFAB). Gjeneral Kingji shprehu vlerësimin për kontributin që SHBA-ja ka dhënë në trajnime, pajisje (përfshirë automjetet e urgjencës dhe gomone) dhe furnizime të tjera. >>> faqe 3



FA, gatishmëri e plotë në përballimin e situatës së krijuar nga rreshjet



Konferenca Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit SAR në RSH

Në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua Konferenca Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, nën drejtimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit. E pranishme në konferencë ishte zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, Drejtor i Përgjithshëm i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, Jose Carlos Rosa Angeja, si dhe drejtues të tjerë të drejtorive të MM dhe SHPFA...



>>> Faqe 5

Përfundon kursi 52 Bazë në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të kursit 52 Bazë të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve, stafi i komandantit, personel nga Dega e Administratës dhe Arsimit, instruktorë dhe mësimdhënës. Në këtë ceremoni përshëndetën instruktori përgjegjës i Kursit Bazë...



>>> Faqe 4

69 vite Arma e Kimisë, shërbimi elitë i FA-së

Shërbimi Kimik i Ushtrisë gjatë gjithë kohës ka qenë shërbim elitë, që përgjigjej para Këshillit të Mbrojtjes për vetë natyrën dhe rëndësinë e veçantë të detyrave që ai zgjidhte për Mbrojtjen e Forcave të Armatosura të popullit e të ekonomisë. Periudha 69-vjeçare e këtij shërbimi ka qenë një periudhë e gjatë pune vetëmohuese e përkushtimi nga qindra kuadro e mijëra ushtarë që kanë shërbyer në këtë armë, që me punën dhe sakrificat e tyre e çuan këtë shërbim në nivelet më të larta të mundshme, shërbim sa i vështirë...



>>> Faqe 10-11

Gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim komandantin e SEEBRIG, gjeneral brigade Evangelos Mitroutsikos

Gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim komandantin e SEEBRIG, gjeneral brigade Evangelos Mitroutsikos, i cili shprehu vlerësimet më të mira për punën profesionale në nënrepartet e Forcës Tokësore, të deklaruar si pjesë e Brigadave të Evropës Juglindore. Nga ana e tij, gjeneral Kingji u shpreh se: “Forcat e Armatosura do mbështesin çdo nismë që kontribuon në sigurinë rajonale dhe që promovon marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë mes shteteve pjesëmarrëse.” Vitin që vjen Shqipëria do të marrë kryesinë e radhës së SEEBRIG.



Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm viziton Forcën Ajrore

Kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në vijim të programit mësimor për vitin akademik 2022-2023 zhvilluan vizitë njohëse në Bazën Ajrore të Farkës. Kursantët u mirëpritën nga drejtuesit e Komandës së Bazës Ajrore, të cilët i njohën ata me misionin, strukturën, detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj force. Prezantimi u realizua në formën e bashkëbisedimit në të cilin kursantët dhe drejtues të Forcës Ajrore diskutuan angazhimet e Forcës Ajrore për realizimin e detyrave në kuadrin e Forcave tona të Armatosura dhe ato të NATO-s, si dhe planet e zhvillimit dhe të modernizimit të Forcës Ajrore për t’iu përgjigjur sfidave në mjedisin e ri të sigurisë. Në vijim kursantët vizituan ambientin e dislokimit të helikopterëve, ku me mjaft interes ndoqën nga instruktorët se si realizohet një praktikë fluturimi. Vizita u koordinua dhe realizua nën kujdesin e Departamentit të Operacioneve Ushtarake të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të drejtuar nga kolonel Isuf Hamati.



Profesionalizëm i lartë i treguar nga efektivistët e kontingjentit “KFOR-2”, të trupave komando të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), me mision në Kosovë, gjatë zhvillimit të trajnimit mbi reagimin ndaj thyerjes së perimetrit të sigurisë dhe eliminimit të elementëve terroristë pengmarrës brenda bazës.



Oficerët e batalionit të Dytë të Këmbësorisë, treguan vlerat dhe aftësitë më të mira profesionale, gjatë stërvitjes “Quick Response”, të zhvilluar në Bosnje-Hercegovinë.



SEEBRIG, vizitë vlerësuese në Forcën Tokësore



Gjeneral brigade Arben Kingji, takim me ambasadoren Yuri Kim

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim ambasadoren amerikane në Tiranë, Yuri Kim. Në këtë takim ata diskutuan mbi forcimin marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes mes SHBA-së dhe Shqipërisë. Ata ranë dakord të rrisin bashkëpunimin në vazhdim të stërvitjes historike "Defender Europe 2021", dhe në përgatitje për stërvitjet e ardhshme "Defender Europe 2023". Të dy diskutuan ndikimin pozitiv të selisë së Komandës së Forcave Operacionale Speciale të SHBA-ve (SOCEUR), në Shqipëri dhe aktivitetet e Brigadës së Forcave të Sigurisë dhe të Ndihmës së Ushtrisë së SHBA-ve (SFAB).

Gjeneral Kingji shprehu vlerësimin për kontributin që SHBA-ja ka dhënë në trajnime, pajisje (përfshirë automjetet e urgjencës dhe gomone) dhe furnizime të tjera.



Respekt dhe mirënjohje për të gjithë efektivet e angazhuar në situatën e vështirë të krijuar prej reshjeve të dendura në territorin Shqiptar dhe sidomos në Qarkun Shkodër, ku për më shumë se 30 orë në terren, kanë vijuar operacionet e kërkim-shpëtimit, ndihmës dhe evakuimit të mbi 240 banorëve nga zonat e përmbytura.

Ky është shembulli që transmetojnë forcat tona të armatosura në ditë të tilla të vështira, që me përgatitjen e duhur dhe ndjenjën e lartë të detyrës, bënë që kjo sfidë e përbashkët të bëhet më e lehtë, duke i ardhur në ndihmë komunitetit dhe shmangur dëmet serioze në njerëz.

FA, gatishmëri e plotë në përballimin e situatës së krijuar nga rreshjet



Përfundon kursi 52 Bazë në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të kursit 52 Bazë të Nënoficerit.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve, stafi i komandantit, personel nga Dega e Administratës dhe Arsimit, instruktorë dhe mësimdhënës.

Në këtë ceremoni përshëndetën instruktori përgjegjës i Kursit Bazë, kursanti që doli me rezultate të larta gjatë kursit, komandanti i QAPN-së dhe komandanti i AFA-së.

Në fjalën e tij përshëndetëse komandanti i QAPN-së kolonel Ardian Lilo përshëndeti kursantët që përfunduan kursin 52 Bazë të Nënoficerit, i cili ndër të tjera u shpreh: "Tashmë niveli ynë i bashkëpunimit me forcat e armatosura të vendeve të tjera në lidhje me unifikimin dhe shkëmbimin e eksperiencave në sferën e arsimit, është rritur ndjeshëm dhe me ritme shumë të larta e premtuese, që konsiston në



thelb me arsimimin sa më cilësor dhe sa më bashkëkohor të nënoficerëve, duke sjellë kështu edhe risi e kualitet në arsimimin tuaj, pasi ju jeni shtylla kurrrizore e Forcave tona të Armatosura. Kjo gjë vërehet dhe në bashkëpunimin e vazhdueshëm që ne kemi pasur dhe vijojmë të kemi me Gardën Kombëtare të New Jersey-t, si dhe nga intensifikimi i marrëdhënieve bilaterale ushtarake në fushën e arsimit mes institucionit tonë dhe FSK-së, duke shkëmbyer

dhe eksperiencën arsimore në lidhje me kurset mësimore që zhvillohen në FSK dhe në Qendrën tonë, pasi aktualisht në mesin tuaj siç dhe ju e dini, ndoqen kraher për kraher jush këtë kurs 5 kursantë të FSK-së, ku 2 prej tyre personel femër".

Në mbylljen e kësaj ceremonie përshëndeti komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bilbil Bitri, ku në fjalën e tij të rastit ndër të tjera theksoi se: "Gjatë këtyre viteve FA-të kanë qenë në proces të



vazhdueshëm transformimi, ku pjesë e së cilës ka qenë dhe trupa e nënoficerëve. Realisht kjo trupë sot vjen më e përgatitur më e arsimuar dhe më e kualifikuar, ku ne si drejtues na bën që të rrisim besimin, duke ju mbështetur në punën tuaj të përditshme, duke ju deleguar më shumë përgjegjësi e kompetencat e nevojshme për kryerjen e detyrës së caktuar".

E veçanta e kësaj ceremonie ishte dhe certifikimi i 5 kursantëve nga FSK-ja, mes 30 kursantëve të ardhur nga Repartet e Njësitë e Forcave tona të Armatosura.



Gjeneral brigade Bilbil Bitri: Krenarë për punën dhe përpjekjet tuaja në konsolidimin e sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura

Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, u zhvillua ceremonia e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi, në Bunavi, b1k, b3k të FT-së dhe Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, u certifikuan 118 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bilbil Bitri, i cili shprehu vlerësime për rekrutët e sapo certifikuar dhe konsiderata të veçanta për ceremoninë e zhvilluar, gjithashtu, komandanti i AFA-së, falënderoi familjarët, të afërmit e rekrutëve pjesëmarrës në ceremoni, dhe personelin trajnues, ku ndër të tjera theksoi: "Ndihe mi krenarë për produktin e punës suaj, për këtë forcë ushtarake që keni stërvitur, për përpjekjet tuaja të vazhdueshme në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara në procesin stërvitor, për gjithçka që ju keni bërë për edukimin e këtyre të rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura".

Fjalën e rastit në këtë ceremoni e mbajti Komandanti i QAPU-së, nënkolonel Bujar Fejzo, i cili ndër të tjera falënderoi rekrutët e sapo certifikuar: "Ju shpreh mirënjoi



hjen time për përkushtimin dhe seriozitetin treguar, për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes këtu në Bunavi. Jam i sigurt se dijet dhe aftësitë e fituara do t'ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e Forcave të Armatosura ku do të shërbeni. Dita e sotme është e veçantë për ju, - vijoi

përshëndetjen nënkolonel Fejzo, -pasi do të betoheni si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për t'i qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit". Mes urimeve më të mira, rekrutët u përcollën nga Bunavia për në repartet e Forcave të Armatosura.

Kursantët e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, vizitë mësimore në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit

Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë krijoi kontaktet dhe bashkëpunimin e duhur për zhvillimin e një seminari në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë për kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Drejtues dhe kursantë të kolegjit u pritën nga prof. dr. Dhurata Shehri, zëvendës Dekane, prof. asoc. dr. Alban Tartari dhe prof. asoc. Zylyftar Bregu pedagog, të cilët i uruan mirëseardhjen dhe i falënderuan pjesëmarrësit për prezencën. Në vijim prof. asoc. dr. Alban Tartari realizoi një prezantim të zgjeruar me temë "Angazhimi me median dhe marrëdhëniet publike", duke u ndalur tek roli dhe angazhimet e strukturave ushtarake në fushën e medias dhe komunikimit publik.

Kursantët treguan mjaft interes për temën dhe drejtuan pyetje mbi tendencat e medias kombëtare dhe ndërkombëtare, fuqinë e saj dhe ndryshimet e pritshme në të ardhmen.

Vizita mësimore u mbyll me fjalën e shefit të departamentit, kolonel Mehmet Metko dhe zëvendës Dekane prof. dr. Dhurata Shehri, të cilët shprehën rëndësinë e bashkëpunimeve kërkimore, shkencore, shkëmbime lektorësh etj., mes Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.





Konferenca Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit SAR në RSH

Në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua Konferenca Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, nën drejtimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit. E pranishme në konferencë ishte zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra, Drejtor i Përgjithshëm i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, Jose Carlos Rosa Angeja, si dhe drejtues të tjerë të drejtorive të MM dhe SHPPFA. Në konferencë të pranishëm ishin dhe prefektë të qarqeve të ndryshme.

Konferencën e hapi kryetari i QKKSH, kolonel Fiqiri Hoxha, i cili pasqyroi aktivitetin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit SAR, funksionimin e shërbimit efektiv SAR në Republikën e Shqipërisë, harmonizimin e shërbimeve SAR ajrore dhe lundrimit detar, shpëtimin e njerëzve në rast fatkeqësie, transportin e udhëtarëve, si dhe zhvillimin e tregtisë, turizmit dhe ekonomisë.

Konferencën e përshëndeti zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj theksoi se:

“Pjesëmarrja në këtë aktivitet, gjykoar nga qëllimi dhe vlerat e tij, është një përgjegjësi institucionale, si drejtuesi më i lartë ushtarak i Forcave të Armatosura, të cilat kanë rolin dhe peshën specifike operacionale përcaktuese në operacionet e kërkim-shpëtimit.

Për shumë arsye, sikurse e kanë treguar eksperiencat dhe praktikat e deritanishme, Forcat e Armatosura kanë qenë dhe mbeten institucioni kryesor, ku autoritetet, por edhe komunitetet, janë drejtuar dhe kanë besuar në kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit. Kjo përbën një vlerë të shtuar, por edhe një detyrim të madh.

Në të vërtetë, Forcat e Armatosura, si një nga komponentët kryesorë të këtij sistemi, gjithmonë kanë treguar gatishmëri dhe aftësi në përballimin dhe menaxhimin e situatave të vështira. Ajo që ne në Forcat e Armatosura kemi kuptuar është fakti se në një botë të ndërvarur e të ndërlidhur, komplekse në organizim, lëvizje dhe zhvillim, por edhe në sfida, është e pamundur që një entitet dhe kapacitet i veçantë, sado i fuqishëm qoftë ai, të mund të kryejë i vetëm një mision kompleks”

Më tej gjeneralmajor Shehu do vazhdonte: “Jemi të vetëdijshëm se të



gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, që kanë një angazhim të drejtpërdrejtë dhe më të madh në operacionet e kërkim-shpëtimit kanë nevojë për plotësime dhe rinovim të teknikës dhe pajisjeve, krahas me një përzgjedhje, kompletim dhe trajnim të domosdoshëm

specifik. Forcat e Armatosura, sa herë është kërkuar nga autoritetet dhe është imponuar nga situatat, janë angazhuar në kërkim-shpëtim me performancë dhe rezultate të prekshme dhe të ndjeshme, pavarësisht kufizimeve në kapacitete dhe asete. Konferenca i zhvilloi punimet

në dy panele, ku u trajtuan tema si: “Ngritja e një shërbimi efektiv SAR; Promovimi dhe harmonizimi i shërbimeve SAR, ajror dhe detar; Inkurajimi i strukturave të shtetit shqiptar për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimit SAR; si dhe, Bashkëpunimi me shtetet fqinje

dhe konsiderimi i shërbimeve SAR të tyre si pjesë e një sistemi global”. Në përfundim u shtruan disa detyra për përmirësimin dhe konsolidimin e shërbimit të Kërkim-Shpëtimit si dhe u shpërndanë certifikata mirënjohjeje për kontributin e dhënë.



Në "tregun" e librit...

SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

MË SHUMË FOTO SE LIBRA TË BLERË!

Panairi i librit 2022, mbajtur në Tiranë, uli siparin. Ky është një aktivitet i përvitshëm, i cili mbledh grupmosha të ndryshme, nën logon "Bli një libër" apo "Shëtit mes standave të shtëpive botuese".

Natyrisht, për shkak të rrethanave jo të volitshme ekonomike, por edhe për shkaqe subjektive dhe raportit të dukshëm refuzues ndaj librit, botuesit do të jenë ata që do ta thonë fjalën e fundit për interesimin ndaj librit, ndonjë vend për optimizëm nuk ka.

Tani e tutje, qasja ndaj aktiviteteve të formateve të këtyre dimensioneve, siç është libri, duhet të ndryshojë, sepse rrezikon të bëhet monoton, për shkak të skenarit të njëjtë që përsëritet vit pas viti.

Ky format ka vetëm një qëllim, atë material. Në të kundërtën, edhe kjo e fundit, do të zbehet dhe do të bjerë në minimum, për të mos thënë se do të bëhet simbolik.

Edhe pse dikujt do t'i dukej normale, sërish u vërejt një dukuri që mund të haset vetëm në tregun e frutave dhe perimeve, ku shitësit zëshëm njoftojnë dhe ftojnë blerësit. Lutjet e autorëve: "ejani në kaq ora do të jemi me ju...në kaq ora është promovimi... në kaq ora nënshkruajmë libra"...nuk janë aq të këndshme, sepse është punë ekskluzivisht e shtëpive botuesve.

Por, çfarë tregoi FB për këtë panair. Sërish rrjetet sociale dominante për promovim.

Mbi të gjitha, tregoi se edhe këtë Panair e vizituan, ndër të tjerë, edhe shumë mediokre, që shkuan në këtë ngjarje të madhe kulturore për të bërë foto brenda hapësirave të Pallatit të Kongreseve, por edhe jashtë.

Është më se e sigurt se më shumë u bënë foto se sa u blenë libra. Dëshira për të shkuar në Panair, sa për ta bërë një foto dhe për t'ia treguar botës "intelektualizmin", është një veti mediokre tipike e atyre që vuajnë nga komplekse të ndryshme.

Ndaj, që të jemi të ndërgjegjshëm dhe të moralshëm në raport me librin dhe autorët shqiptarë qasja ndaj një ngjarjeje të tillë me përmasa kombëtare, duhet të pësojë ndryshim për 180 shkallë, thjeshtë për t'ia kthyer dinjitetin librit shqip, shkrimtarëve, por edhe botuesve.

Duhet bërë përpjekje për një ndryshim rrënjësor, duke e shndërruar panairin, nga ai me karakter shit-blerës në atë ekspozues, ku mblidhen në një vend botues, shkrimtarë, përkthyes dhe dashamirët e librit, ku të prezantohet opusi i shtëpive botuese, organizohen debate, lidhen kontrata të reja e kështu me radhë, ndërkaq, pastaj libri u lihet librarive.

Librin shqip duhet ta shpëtojmë



nga kriza. Nëse të gjithë kontribuojnë nga pak, atëherë libri vërtet do të konsiderohet si një ushqim i domosdoshëm shpirtëror dhe patjetër që do të jetë në shtëpitë tona...

Po çfarë duhet të bëjmë?

Një projekt të thjeshtë për ta arritur faktin e pajisjes me pesë libra çdo shkollë, çdo bibliotekë shkolle, universiteti, burgu, spitali, reparti ushtarak, stacion policie etj., pa vërejtje që të sflitin, pa

asgjësuar seriozitetin dhe njeriun e dytë brenda intelektualit, studentit, nxënësit, mësuesit.

Shpeshherë, siç na ndodh rëndom të gjithëve, jo për arsien e thjeshtë ekzistenciale se duhet që të mbështetemi te leximi, pa ia kthyer shpinën librit, në vend që ta mbulojmë atë me harrim, por më fort kjo iniciativë të bëhet ngasje e papërbalueshme për shkollat dhe institucionet që do pajisen me libra të shumtë.

Kështu formojmë shijet e të lexuarit, duke njohur manierat, kompleksitetin e karakterit shqiptar, por jo vetëm, në mënyrë të thellë, që e peshojmë shumë gjithçka përpara se të ndërmarim një veprim konkret e të bukur. Domethënë mësojmë! Dhe kjo s'është brejtje ndërgjegjeje, as trishtim, as interpretim i gabuar! Kjo s'mund të përsëritet kurdo e sido! Ç'është kjo mbyllje, që s'i bën askujt përshtypje, ku struket e humbet

Qasja ndaj aktiviteteve të formateve të këtyre dimensioneve, siç është libri, duhet të ndryshojë, sepse rrezikon të bëhet monoton, për shkak të skenarit të njëjtë që përsëritet vit pas viti.

çdo ide e mendim? Dhe, për ironi, jemi në kohën e demokracisë! Po, përmasat e reja të jetës, çmontimi i sistemit të vjetër po zgjatet shumë, shpresat po ashtu veniten, ndërkohë që vijnë zhgënjime, mosdurim, emigrim, nostalgji, thuajse të përditshme, luftë, kurajë, rrënim e rroposje karakteri, ngrenë krye në vetëdije rrangullat e sistemit të vjetër, po nuk po ngrihet kurrëgjë në frontin e kulturës e të librit.

Ja ç'ndodh me ne: libra prodhohen aq sa s'ta pret mendja për mundësitë tona, dhe libra bibliotekat tona s'kanë! Kudo! Veç bibliotekës kombëtare, që u rrëmben nga pesë libra pa pagesë kujtdo botuesi dhe kaq mjafton, kur libri (edhe ai elektronik) duhet të jetë në çdo shtëpi e jo më në çdo shkollë...

Pra, na duhet të lexojmë shumë, sidomos të lexojmë veprat e mëdha, të ngrihemi lart, të vrojtojmë botën e mbështjellë keq nga trazirat dhe viruset që do t'i kemi pas përjetësisht...



69 vite Arma e Kimisë, shërbimi elitë i FA-së

Shërbimi Kimik i Ushtrisë gjatë gjithë kohës ka qenë shërbim elitë, që përgjigjej para Këshillit të Mbrojtjes për vetë natyrën dhe rëndësinë e veçantë të detyrave që ai zgjidhte për Mbrojtjen e Forcave të Armatosura të popullit e të ekonomisë. Periudha 69-vjeçare e këtij shërbimi ka qenë një periudhë e gjatë pune vetëmohuese e përkushtimi nga qindra kuadro e mijëra ushtarë që kanë shërbyer në këtë armë, që me punën dhe sakrificat e tyre e çuan këtë shërbim në nivelet më të larta të mundshme, shërbim sa i vështirë aq dhe i nevojshëm, si për kohë lufte dhe për kohë paqeje, shërbim human që mbron dhe shpëton jetë njerëzish në çdo situatë. Kjo ka qenë dhe do të mbetet përherë detyra e mbrojtjes kundërkimike.

Nënreparti i parë i shërbimit të mbrojtjes kundërkimike, u krijua më 23 nëntor të vitit 1953. Komandanti i Nënrepartit të parë të shërbimit kimik (kështu quhej struktura e parë e krijuar) u emërua Shyqyri Kondi. Po në këtë kohë, me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes u krijua edhe Dega e Mbrojtjes kundërkimike pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Kuadrot e para ishin ato të dalë nga lufta antifashiste dhe të përgatitura me kurse dhe kryesisht në shkollat ushtarake të ish-Bashkimit Sovjetik dhe më vonë në Akademinë tonë të Mbrojtjes si Shyqyri Kondi, Kristaq Haxhimiali, Thodhori Gjoni, Hamit Murga, Uran Puto, Abdyl Dobi, Esat Xhepa Guri Shyti, Lame Prifti, Qëndro Laba, Enver Lagji, Hysen Murtati, Sami Meçollari, Hysen Kola, Kristaq Mici, Pirro Begvarfi, Zija Liçi, Servet Muka e shumë e shumë të tjerë, që dolën më vonë nga Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve.

Në vitin 1954, pranë Shkollës së Bashkuar të oficerëve, u hap edhe Kursi i Kimisë, që filloi të përgatiste kuadrot e parë të vendit, të cilët me ndjenjë të lartë dhe përkushtim rritën nivelin teknik dhe gatishmërinë luftarake të reparteve dhe njësisve të Ushtrisë.

Gradualisht, me rritjen e modernizimit e ushtrisë u shtua dhe u modernizua edhe shërbimi kimik, që ndonjëherë edhe e quanim Arma e Kimisë, dhe kjo për përmasat dhe rëndësinë që mori. Kështu në vitin 1961, kompania e kimisë u kompletua me teknikën e armatimit kimik, me teknikë zbulimi dhe përpunimi. Rëndësi e veçantë fillimisht, i kushtojë përvetësimin të teknikës dhe kompletimit të ushtrisë me mjetet e mbrojtjes kundërkimike.

Në vitin 1964, pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm, u hap dega e Mbrojtjes Kundërkimike, me shef katedre n/kolonel Kristaq Haxhimihalini, prej ku filluan të dalin kuadrot e lartë ushtarakë.

Në vitin 1967, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes u krijuan tre batalione, dy të mbrojtjes kundërkimike, njëri në Tiranë me komandant Koço Stojkun dhe tjetri në Berat me komandant Refat Shehatin kurse batalioni i tretë ishte ai flakëdhës në Tiranë me komandant Ahmet



Mehmetin, që të tre Rezervë të Shtabit të Përgjithshëm.

Po në këtë kohë, pranë shtabeve të divizioneve u krijuan kompanitë e mbrojtjes kundërkimike dhe ato flakëdhëse, të cilat me kalimin e ushtrisë në sistemin mek, kaluan në batalione kimie dhe flakëdhëse, të kompletuara me teknikë dhe armatim të plotë kimik. Po kështu, pranë korpuseve u krijuan edhe laboratorët e kimisë të korpuseve me shefa laboratorësh inxhinierë kimistë, që kishin në vartësi edhe oficinat e riparimit të teknikës dhe armatimit kimik të korpusit dhe që kanë bërë një punë të lavdërueshme për rritjen cilësore teknike të këtij shërbimi.

Më 1969, pranë reparteve të kimisë në Brar, u krijua Shkolla e Përgatitjes së Kuadrove Oficer Rezervist, me komandant Muharrem Durmishi.

Zhvillimi i vrullshëm i shërbimit kimik bëri që edhe drejtimi të kalonte nga degë në Drejtori të Mbrojtjes kundërkimike. Në këtë kohë, kur drejtues të saj ishin Enver Lagji dhe Muharrem Durmishi, u bë një punë shumë e madhe në drejtim të studimit dhe prodhimit në vend të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike dhe të likuidimit të pasojave të ndotjeve. Është pikërisht kjo kohë, kur u krijuan shumë grupe pune studimore me specialistët më të mirë, të cilët e kurorëzuan me sukses krijimin e uzinës së kimisë, që prodhoi kundërgazin shqiptar me parametra të matshëm me bashkëkohorët, u prodhua paketa individuale kundërkimike, kompletet e degazimit e përpunimit, kostumet mbrojtëse e kompleti mbrojtës i parë e shumë të tjera.

Pranë ambienteve të kompanisë së kimisë, më 1 gusht 1965, u hap Laboratori Qendror i kimisë në FA, me kimistin e talentuar Kudret Meta dhe dy laborantë. Hapja e këtij Laboratori kishte si qëllim përgatitjen teknike të kuadrove të mesëm dhe të lartë të kimisë, kryesisht si një bërthamë studimore për aplikimin në ushtri të të rejave shkencore lidhur me ADM (Armët e Dëmtimit në Masë) dhe mbrojtjen prej tyre, sidomos në drejtim të armës

së kimisë dhe mjeteve djegëse, për t'iu përgjigjur situatave të mundshme kimike, që mund të krijoheshin, duke e përqendruar vëmendjen fillestare në këto probleme:

- gjetja dhe aplikimi i metodave të analizave të lëndëve helmuese luftarake;
- kryerja e analizave të lëndëve ç'ndotëse, që mbahen në ruajtje;
- aplikimi i metodikave për përgatitjen dhe përdorimin e mjeteve ç'ndotëse;
- studimi i aftësisë mbrojtëse të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike;
- përgatitja e përzierjeve djegëse për flakëdhësit.

Jo vetëm kaq, por prodhoi dhe furnizoi edhe industrinë me gypa indikatorë për gazrat e dëmshëm industrial,

LHL (agjentët kimikë) + Mjetet e përdorimit = Arma e kimisë

Ushtria jonë ka pasur në dispozicion vetëm një nga dy komponentët që përbëjnë Armën e Kimisë LHL dhe nuk ka disponuar asnjëherë mjete të përdorimit të tyre.

Shqipëria, deri në vitin 2007, ka trashëguar nga sistemi i kaluar komunist rreth 16 ton iprit mësimor, sasi të vogla të klorpikrinës – LHL ngacmuese – asfiktike, që është përdorur vetëm në Luftën e Parë Botërore për qëllime luftarake. Po ashtu, kemi pasur sasi të vogla (jo me ton dhe kuintal, por me kg-iprit luftarak, luizit dhe sarin, që janë përdorur për studime shkencore. Vonë janë sjellë sasi të vogla kloracetofeni.



hoqi nga importi shumë kimikate dhe lëndë të tjera të domosdoshme për prodhimin e këtyre gypave.

Që nga viti 2007, me mbështetjen e qeverisë Amerikane dhe nën monitorimin e plotë të OPCW (Organizata për ndalimin e armëve kimike), u bë asgjësimi i plotë i të gjithë sasisë së LHL-së (agjent kimik), që ka disponuar Shqipëria.

Laboratori Kimik, në vitin 1969, arriti që me këmbëngulje të sintetizonte (prodhonte) pothuajse të gjitha llojet e LHL-së që njiheshin përfshi sarinë në sasi shumë të vogla dhe kjo është bërë për të pasur mundësi të studioheshin e prodhoheshin mjetet e zbulimit të tyre kimik të mbrojtjes prej tyre dhe të mos ndotjes së tyre.

Laboratori prodhoi të gjithë gypat

indikatorë të lëndëve helmuese. Sasitë e saj kanë qenë tepër të vogla dhe nuk është përdorur asnjëherë për qëllime luftarake, manovra apo stërvitje.

Kur përmendet kjo armë, në kujtesë të vjen menjëherë kundërgazi. Te ne, fillimisht erdhën modele sovjetikë dhe kinezë, por më pas u arrit të prodhohet në vend nga Ndërmarrja e Prodhimeve Kimike të Ushtrisë në Tiranë.

Kundërgazi eksperimental u prodhua në vitin 1971, ndërsa në vitet 80-të, kur punohej me ritëm të plotë për të kompletuar të gjitha nevojat e ushtrisë, sasia vjetore arriti në 100 000 komplete në vit. Maska dhe gypi i kundërgazit prodhoheshin nga Ndërmarrja Gomë-Plastikë, Durrës.

Ndërmarrja Kimike u nda me administratë më vete dhe u quajt "Rep. Ush.1190". Aty nisën të prodhoheshin karboni aktiv dhe katalitik për mbushjen e kundërgazeve, kutitë tymuese individuale dhe të tankeve (ku ngjeshja e kalëpit me lëndën përbërëse kryej me një presë me friksion 120 ton, të realizuar nga Kombinati Metalurgjik Elbasan), si dhe produkte të tjera për stërvitje. Karboni aktiv dhe katalitik prodhohej nga bërësit e farave të ullirit. Përveç kundërgazit individual, ishin dhe filtrat e mbrojtjes kolektive, të cilët montoheshin në strehime apo objekte të tjera. Përveç këtyre, ishin dhe filtrat 50 dhe 100 m³/orë. Filtrat kanë të njëjtin konstruksion si të kundërgazit individual, pra një element filtrues prej letre të valëzuar dhe një element filtrues prej karboni katalitik. Parafiltri, siç e thotë dhe emri, është i përbërë vetëm nga element filtrues prej letre me strukturë speciale. Për këto filtra u kryen studime për t'i prodhuar në vend dhe u arrit deri te prodhimi eksperimental i prototipave.

Tepër i vështirë ishte realizimi në rugë industriale i letres së valëzuar (si fizarmonikë). Te parafiltri, kishte përmasat e një fizarmonike të vogël. Problem i kushtueshëm ishte dhe mbyllja e kapakut në po atë mënyrë siç mbyllet dhe kutitë e konservave. Te kundërgazi individual, këto probleme ishin zgjidhur, sepse kishte përmasa të vogla. Gati një industri e tërë e realizuar me mjeshtëri nga ushtarakët tanë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM MERR PJESË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-S, MADRID

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Stoltenberg: Nëse lejojmë Putinin të fitojë, të gjithë do të duhet të paguajmë një çmim shumë më të lartë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, mori pjesë në Sesionin e 68-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (NPA) në Madrid, Spanjë, më 21 nëntor 2022. Sekretari i Përgjithshëm kujtoi vendimet kryesore të Samitit të NATO-s në Madrid në qershor, duke përfshirë rritjen e mbështetjes për Ukrainën, forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes, miratimin e Konceptit të ri Strategjik dhe ftesën e Finlandës dhe Suedisë për t'u bashkuar me NATO-n. "Ndërsa presim samitin tonë në Vilnius, në Lituani, vitin e ardhshëm, ne po i zbatojmë këto vendime", - tha z. Stoltenberg dhe mbështetja e parlamentarëve do të jetë jetike, tha ai. Sekretari i Përgjithshëm u kërkoi ligjvënësve se: "ne duhet të qëndrojmë së bashku në kursin për Ukrainën", duke theksuar se: "nëse lejojmë Putinin të fitojë, të gjithë ne do të duhet të paguajmë një çmim shumë më të lartë. Regjimet autoritare në mbarë botën do të mësojnë se mund të arrijnë atë që duan me forcë brutale."

Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi se investimi më shumë në mbrojtje do të jetë një temë e rëndësishme në Samitin e Vilniusit të vitit të ardhshëm. Ai tha se pret që aleatët të vazhdojnë të bëjnë përparim, duke përfshirë angazhimet përtej vitit 2024, sepse 2% e PBB-së në mbrojtje duhet të konsiderohet një dysheme, jo një tavan. Z. Stoltenberg theksoi gjithashtu se ka ardhur koha për të finalizuar procesin e anëtarësimit dhe për të mirëpritur Finlandën dhe Suedinë si anëtarë të plotë të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me kryeministrin spanjoll Pedro Sánchez për të diskutuar axhendën e NATO-s pas Samitit të Madridit.

Sesioni i 68-të vjetor i Asamblesë Parlamentare të NATO-s (NPA)

Në fjalën e tij, në sesionin e 68-të vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (NPA), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe shprehu kënaqësinë për t'u drejtuar këtij Kuvendi, si dhe shprehu kënaqësinë për kthimin në Madrid. "Hera e fundit që erdha në Madrid ishte kur patëm Samitin e mrekullueshëm të NATO-s këtu në qershor. Mendoj se si pritja e Samitit ashtu edhe ajo e Asamblesë Parlamentare të NATO-s demonstrojnë përkushtimin shumë të fortë të Spanjës ndaj Aleancës sonë transatlantike. Në Samitin e Madridit morëm disa vendime shumë të rëndësishme në një moment kritik për Aleancën tonë. Ne morëm vendime të guximshme për një sërë çështjesh", - tha ai dhe shtoi: "Ne vendosëm të rrisim mbështetjen për Ukrainën; të forcojmë më tej shkurajimin dhe mbrojtjen tonë; ftuam Finlandën dhe Suedinë të bëhen anëtarë të NATO-s; miratuar gjithashtu Konceptin Strategjik të Madridit, për të përshtatur Aleancën në një botë më të rrezikshme dhe më konkurruese. Pra, Samiti në Madrid ishte me të vërtetë një Samit transformues. Dhe tani, ndërsa shohim përpara, Samitin tonë në Vilnius, në Lituani, vitin e ardhshëm, ne po zbatojmë vendimet që morëm në Madrid", - tha Stoltenberg.

Së pari, Ukraina

"Presidenti Putin bëri dy gabime të mëdha strategjike kur pushtoi Ukrainën në shkurt të këtij viti. Ai nënvlerësoi trimërinë dhe vullnetin e ukrainasve për të luftuar dhe ai nënvlerësoi unitetin dhe vendosmërinë e pamëshirshme të



aleatëve dhe partnerëve të NATO-s për të mbështetur Ukrainën. Ai mendoi se mund ta mposhtë Ukrainën brenda pak ditësh. Nëntë muaj më vonë, Rusia vazhdon të përballet me pengesa dhe ukrainasit vazhdojnë të çlirojnë territorin e tyre nga pushtimi. Së fundmi, Kherson. Por do të ishte një gabim i madh të nënvlerësohej Rusia. Ajo ruan aftësi të konsiderueshme ushtarake dhe një numër të lartë trupash. Rusia është e gatshme të pësojë viktima të konsiderueshme dhe është e gatshme të shkaktojë vuajtje të tmerrshme mbi popullin ukrainas. Ne kemi parë dronë dhe raketa që godasin qytetet e Ukrainës, civilët dhe infrastrukturën kritike. Pra, ne duhet të jemi të përgatitur për të mbështetur Ukrainën për një kohë të gjatë. Po, e di që kjo mbështetje ka një çmim", - tha sekretari i Përgjithshëm.

Në vendet tona, shumë njerëz përballen me një krizë të kostos së jetesës. Faturat e energjisë dhe ushqimit po rriten. Këto janë kohë të vështira për shumë njerëz. "Por çmimi që ne paguajmë si aleatë të NATO-s matet me para. Ndërsa ukrainasit, ata paguajnë një çmim që matet me gjak dhe nëse lejojmë Putinin të fitojë, të gjithë ne do të duhet të paguajmë një çmim shumë më të lartë. Regjimet autoritare në mbarë botën do të mësojnë se mund të arrijnë atë që duan me forcë brutale. Kjo

do të kishte pasojë të drejtpërdrejta për sigurinë tonë. Do ta bënte botën më të rrezikshme dhe ne jemi më të pambrojtur. Kjo është arsyeja pse ne nuk mund të lejojmë që presidenti Putin të fitojë në Ukrainë. Kështu që ne duhet të qëndrojmë së bashku. Dhe unë mbështetem tek të gjithë ju, si anëtarë të parlamentit, që të vazhdoni të mbështesni Ukrainën".

Së dyti, parandalimi dhe mbrojtja

"Ne kemi forcuar mbrojtjen tonë që nga viti 2014, në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia. Ne kemi zbatuar përfundimisht në të madh të mbrojtjes sonë kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Tani po bëjmë edhe më shumë. Për të parandaluar që konflikti në Ukrainë të përshkallëzohet përtej Ukrainës. Pra, ne kemi dyfishuar numrin e grupeve luftarake në pjesën lindore të Aleancës, nga katër në tetë. Rritëm aftësinë tonë për t'i përforcuar ato deri në nivelin e brigadës. Ne po vendosim më shumë trupa në gatishmëri më të lartë, që ata mund të përgjigjen më shpejt kudo dhe kurdo që të jetë e nevojshme", - theksoi shefi i NATO-s. "Por për ta bërë këtë, ne duhet të investojmë më shumë në mbrojtje. Ne kemi marrë tashmë, siç e dini, shumë vendime të rëndësishme dhe kemi bërë, së bashku, shumë përparim. Viti 2022 do të jetë viti i tetë radhazi i rritjes së

shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë Europën dhe Kanadanë.

Deri në fund të vitit, ne do të kemi shpenzuar mbi 350 miliardë dollarë shtesë për mbrojtjen, që kur bëmë zotimin në 2014 në të gjithë Europën dhe Kanadanë. Në Samitin në Vilnius, investimet në mbrojtje do të jenë një temë e rëndësishme dhe unë pres që aleatët të vazhdojnë të bëjnë përparim, përfshirë angazhimet pas vitit 2024. Sepse 2% e PBB-së për mbrojtjen duhet të konsiderohet si një dysheme, jo një tavan për investimet tona në mbrojtje. Këtu përsëri, unë vazhdoj të mbështetem në mbështetjen tuaj", - tha ai.

Së treti, qëndrueshmëria

"Një nga mesazhet kryesorë në Konceptin Strategjik të Madridit është lidhja midis mbrojtjeve të forta dhe shoqërive të forta. Lufta në Ukrainë ka ekspozuar disa dobësi kryesore. Për një kohë të gjatë, ne kemi qenë të varur nga nafta dhe gazi rus për të ngrohur shtëpitë tona dhe për të fluturuar avionët tanë. Ne kemi parë se si Rusia e ka armatosur energjinë dhe është përpjekur ta përdorur atë për të na shantazhuar dhe për të na penguar të mbështesim Ukrainën", - tha Stoltenberg. "Por Putini nuk ia ka dalë. Aleatët tani po i diversifikojnë furnizimet e tyre. Ne po largohemi nga energjitë fosile dhe po

investojmë në burime të rinovueshme. Kjo është e mirë për sigurinë tonë dhe është e mirë për klimën. Por duhet të jemi të kujdesshëm që të mos krijojmë varësi të reja. Më së shumti në Kinë. Ne shohim përpjekje në rritje kineze për të kontrolluar infrastrukturën tonë kritike, zinxhirët e furnizimit dhe sektorët kryesorë industrialë. Minerat kineze të rrallë të tokës janë të pranishme kudo. Përfshirë në telefonat tanë, makinat tona dhe pajisjet tona ushtarake. Ne nuk mund t'u japim regjimeve autoritare asnjë shans për të shfrytëzuar dobësitë tona dhe për të na minuar. Për këtë, është thelbësore që ne të rrisim qëndrueshmërinë e shoqërive tona dhe infrastrukturës sonë.

Qëndrueshmëria është një përpjekje kolektive, dhe unë mbështetem tek ju të gjithë për të luajtur rolin tuaj edhe këtu".

Së fundi, Finlanda dhe Suedia

Në Madrid, të gjithë aleatët morën vendimin historik për të ftuar këto dy vende për t'u anëtarësuar në NATO, ato nënshkruan protokollet e anëtarësimit dhe tani, procesi i ratifikimit pothuajse ka përfunduar me njëzet e tetë nga tri-dhjetë aleatë që kanë ratifikuar tashmë. "Në Madrid, në qershor, Turqia, Finlanda dhe Suedia nënshkruan Memorandumin Trepalësh.

Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore përbush angazhimin e Komisionit von der Leyen për arritjen e një Unioni të Barazisë. Strategjia paraqet objektivat dhe veprimet e politikave për të bërë përparim të rëndësishëm deri në vitin 2025 drejt një Europe të barabartë gjinore. Qëllimi është një bashkim ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë të lirë të ndjekin rrugën e tyre të zgjedhur në jetë, të kenë mundësi të barabarta për të lulëzuar dhe mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe të udhëheqin shoqërinë tonë europiane.

Objektivat kryesorë janë t'i jepet fund dhunës me bazë gjinore; stereotipe sfiduese gjinore; mbyllja e hendeqeve gjinore në tregun e punës; arritjen e pjesëmarrjes së barabartë në sektorë të



ndryshëm të ekonomisë; adresimi i hendekut gjinor të pagave dhe pensione; mbyllja e hendekut të kujdesit gjinor dhe arrija e ekuilibrit gjinor në vendimarrje dhe në politikë. Strategjia ndjek një qasje të dyfishtë të integritimit gjinor të kombinuar me veprime të synuara dhe ndërsektorialiteti është një parim horizontal për zbatimin e saj. Ndërsa Strategjia fokusohet në veprimet brenda BE-së, ajo është koherente me politikën e jashtme të BE-së për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Si një nga rezultatet e para të Strategjisë, Komisioni propozoi masa të detyrueshme të transparencës së pagave më 4 mars 2021.

Më 8 mars 2022, Komisioni Europian po kërkon, me propozimin e ri në mbarë BE-në për një direktivë për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, të vendosë rregulla minimale të synuara për të drejtat e këtij grupi viktimash të krimit dhe të kriminalizojë format e dhunës ndaj grave dhe dhunës kibernetike.

QIG mbështet inovacionin e mjekësisë


EMA ka krijuar një grup ekspertësh për Inovacionin e Cilësisë (QIG) për

të mbështetur qasje inovative për zhvillimin, prodhimin dhe kontrollin e cilësisë së barnave në dobi të pacientëve në Bashkimin Europian (BE). Këto përfshijnë, por pa u kufizuar në, teknologjitë e reja, dixhitalizimin, materialet e reja dhe pajisjet e reja, në përputhje me prioritetet e theksuara në Strategjinë e Shkencës Rregullatore të EMA-s deri në vitin 2025.

Roli i QIG është të sigurojë që rrjeti rregullator i barnave europiane të ecë në hap me inovacionin, të identifikojë dhe adresojë boshllëqet në kuadrin rregullator dhe të rrisë parashikueshmërinë për zhvilluesit e teknologjive inovative. Grupi do të jetë gjithashtu një forum për shkëmbim dhe ndërveprim brenda rrjetit rregullator të BE-së, si dhe midis rregullatorëve të BE-së dhe palëve të interesuara si akademika dhe industria. Duke pasur parasysh se zhvillimi dhe prodhimi i barnave është i natyrës globale, QIG synon gjithashtu të krijojë një bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë për të lehtësuar konvergencën rregullatore globale.

Detyra të tjera të grupit përfshijnë skanimin e horizontit për të identifikuar

teknologjitë e ardhshme inovative dhe formulimin në mënyrë proaktive të përgjigjeve të përshtatshme rregullatore për secilën prej tyre ndërsa ato piqen. Ekspertiza e QIG mund të përdoret gjithashtu në vlerësimin e ilaçeve



që përdorin këto teknologji inovative në paraqitjet rregullatore si këshillat shkencore, aplikimet për autorizim marketingu dhe ndryshimet e lidhura me ciklin e jetës pas autorizimit.

Grupi i Ekspertëve të Inovacionit të Cilësisë u krijua në shtator 2022 dhe përbëhet nga tetë anëtarë me përvojë në vlerësimin e cilësisë kimike, biologjike dhe inspektimet e Praktikës së Mirë të Prodhimit (GMP). Grupi raporton nën Domenin e Cilësisë të strukturës së grupit të punës së EMA-s.

Praktikat më të mira për të luftuar rezistencën antimikrobike

Koalicioni Ndërkombëtar i Autoriteteve Rregullatore të Barnave (ICMRA) thekson ndërhyrjet e suksesshme rregullatore dhe jo rregullatore të përdorura në vende të ndryshme për të adresuar problemin në rritje të shëndetit publik të rezistencës antimikrobike (AMR) në një raport të ri të botuar sot.

AMR kërcënon aftësinë tonë për të

trajtuar në mënyrë efektive infeksionet për shkak të një game gjithnjë në rritje të bakteve dhe mikroorganizmave të tjerë që janë përshtatur për t'u bërë rezistente ndaj trajtimeve të disponueshme.

Trajtimi i AMR-së është një nga prioritetet strategjike të ICMRA. ICMRA pranon se AMR është një problem kompleks, i shumanshëm dhe bën thirrje për një koordinim më të mirë në të gjithë sektorët, duke përfshirë shëndetin publik, shëndetin e kafshëve dhe mjedisin, përmes një qasjeje “Një Shëndet”. Një përpjekje e bashkërenduar dhe bashkëpunuese është thelbësore për të trajtuar në mënyrë efektive këtë kërcënim ndaj shëndetit, ekonomive dhe sigurisë globale.

Raporti paraqet raste studimore mbi praktikën më të mira nga vende të ndryshme që janë zhvilluar në përputhje me qasjen “One Health” dhe adresojnë AMR-në dhe përdorimin e antimikrobikut tek njerëzit, kafshët dhe mjedisi.

Praktikat më të mira përfshinin fokusin në temat e mëposhtme:

- Fleksibilitete rregullatore që ndihmojnë në sjelljen e terapive të reja në treg
- Raportimi i shitjeve të antimikrobikëve me rëndësi mjekësore për përdorim veterinar që informon

rezistencën antimikrobike/përdorimin antimikrobial për iniciativat e mbikëqyrjes dhe administrimit

- Mësimet e nxjerra nga aftësitë rregullatore të zbatuara në përgjigje të pandemisë COVID-19
- Kufizimi i shitjes dhe furnizimit të disponueshmërisë pa recetë të antibiotikëve
- Zhvillimi dhe progresi i një studimi pilot mbi modelet e rimbursimit për antimikrobiket e rinj
- Raportimi i antibiogramëve selektive për të informuar zgjedhjen antimikrobike
- Reagime mbi të dhënat e përshkruesit për antibiotikë
- Rekomandime trajtimi për infeksionet e zakonshme në kujdesin ambulator
- Zhvillimi i metodave për monitorimin e AMR në mjedis

Studimet e rasteve shërbejnë gjithashtu si mjete për të nxitur diskutime dhe bashkëpunim të mëtejshëm dhe për të forcuar vendosmërinë për të ndërmarrë hapa për të adresuar AMR.



Letërsia Shqiptare, thesari i vyer, vlerë kombëtare


Në kulturën e shqiptarëve ka lënë gjurmën e saj të thellë historia e tyre e brendshme dhe e jashtme. Pjesë e trevave të lashta ilirike, udhë kryqëzimi e qytetërimeve dhe e interesave gjeopolitike gjatë dyndjeve barbare e më pas, provincë e perandorive të perëndimit dhe të Lindjes, të Romës e të Bizantit, pasi kishte bërë e ç' bërë gjatë shekujve, despotate e principata të pavarura, dhe pasi kishte formuar më së fundi shtetin e Skënderbeut, i cili u qëndroi për një çerek shekulli hordhive osmane.

Vendi ishte kthyer pas, në një fazë zhvillimi ekonomiko-shoqëror historikisht të kapërcyer. Rrjedhat normale të kulturës shqiptare, që ecte në një hap me humanizmin evropian, u ndërpre. Pasoja e parë e pushtimit ishte hemorragjia e elitës intelektuale në Perëndim. Prej saj u shquan figura që bënë emër në botën humaniste, si historiani M. Barleti (1460-1513), që botoi në Romë, më 1510, një histori të Skënderbeut, e cila u përkatte thajse në të gjitha gjuhët e Evropës. Ndërkaq, në vend jeta kulturore u fashit, monumentet e kulturës materiale e shpirtërore u zhdukën nën rrënojat e shkatërrimit të luftërave; gjysmëhëna e uli kryqin dhe gati dy të tretat e popullatës në fund të shek. XVII ishin konvertuar në fenë islame. Por ky ndryshim drastik i strukturës fetare nuk pengoi që Shqipëria të ishte përherë një nga provincat më të paqeta të Perandorisë dhe as që kultura shqiptare të mbijetonte edhe në kushtet e një pushtimi disa shekullor, nën tryshninë e islamit e të botës kulturore të orientit, që pati një ndikim të thellë e të gjithanshëm në të, veçse pa arritur të shtypë natyrën shqiptare të kulturës vendëse.

Qëndresa në fushën e kulturës u shpreh në radhë të parë përmes lëvrimin të shqipes në lëmë të botimeve të teksteve kishtarë, kryesisht të qarkut konfesional katolik në veri, por edhe ortodoks në jug. Reforma protestante gjallëroi shpresat e zhvillimit të gjuhës e të traditës letrare vendëse kur prifti Gj. Buzuku solli në shqip liturgjinë katolike, duke dashur të bëjë për shqipen atë që bëri Luteri për gjermanishten.

“Meshari” i Gj. Buzukut, botuar prej tij më 1555, mbahet deri më sot, si e para vepër e shqipes së shkruar.

Niveli i përpunuar i gjuhës dhe ortografia e stabilizuar duhet të jetë rezultat i një tradite më të hershme të shkrimit të shqipes, traditë që nuk njihet. Por ekzistojnë disa dëshmi fragmentare më të hershme se vepra e Buzukut, të cilat flasin për shkrimin e shqipes të paktën nga shek. XIV. E para dëshmi që njihet është e vitit 1332, e dominikanit frëng Guilielm Adale, kryepeshkop i Tivarit, i cili në një relacion latinisht shkruan se shqiptarët kanë në përdorim në librat e tyre shkronjat latine edhe pse gjuha e tyre është fare e ndryshme



nga latinishtja. Me rëndësi të veçantë janë: një formulë pagëzimi e vitit 1492, shkruar shqip brenda një teksti latinisht, nga peshkopi i Durrësit Pal Engjëlli; një fjalor shqip i vitit 1497, i gjermanit Arnold fon Harf, i cili kaloi si udhëtar në Shqipëri dhe një fragment nga Ungjilli i Shën Mateut, po shqip, por me shkronja greqisht, i shekullit XIV.

Shkrimet shqip të këtyre shekujve s’duhet të kenë qenë vetëm tekste fetare, por dhe kronika historike, për të cilat flet humanisti M. Barleti, i cili në librin e tij “Rrethimi i Shkodrës” (1504), pohon se ka pasur në dorë kronika të tilla të shkruara në gjuhën e popullit.

Me gjithë pengesat që krijoi kundër reforma për lëvrimin e gjuhëve nacionale në literaturën kishtarë, ky proces nuk u ndërpre. Gjatë shek. XVI-XVII u botuan në shqip katekizma “E mbësua me krishterë” (1592) e L. Matrëngës, “Doktrina e krishterë” (1618) dhe “Rituale romanum” (1621) të P. Budit, shkrimtari i parë i prozës dhe i poezisë origjinale shqipe, një apologji për Gjergj Kastriotin (1636) nga F. Bardhi, i cili botoi edhe një fjalor e lëndë folklorike, traktati teologjik-filozofik “Çeta e Profetëve” (1685) i P. Bogdanit, mendja më universale e mesjetës shqiptare.

Vepra e Bogdanit është një traktat teologjik-filozofik që trajton me origjinalitet, duke shkrirë të dhëna nga burime të ndryshme, çështje kryesore të teologjisë dhe një histori biblike të plotë, si dhe probleme të komplikuar të skolastikës, të kozmogonisë, astrono-

misë, pedagogjisë, etj. Bogdani solli në kulturën shqiptare frymën humaniste dhe vlerësoi rolin e dijes e të kulturës në jetën e njeriut; ai me veprën e tij të shkruar me një shqipe e stil të përpunuar, shënoi një kthesë në historinë e letërsisë shqipe.

Gjatë shekullit XVIII njohu një gjallërim më të madh literatura e qarkut kulturor konfesional ortodoks e mysliman. Një anonim prej Elbasanit sjell në shqip copa të ungjillit, T. H. Filipi, po prej Elbasanit, “Dhiatën e Vjetër dhe të Re”. Këto përpjekje u shumuan në shekullin e ardhshëm, me botimin, më 1827 të tekstit integral të “Dhiatës së Re” nga G. Gjirakastri dhe me korpusin e madh të përkthimeve kishtarë të K. Kristoforidhit (1830-1895), në dy dialektet e shqipes, botime që ndihmuan procesin e integritetit të tyre në një gjuhë letrare të njësuar dhe vunë bazat për krijimin e kishës kombëtare të shqiptarëve me liturgjinë në gjuhën e tyre.

Ndonëse në kahe të kundërt me këtë prioritet, duhet përmendur edhe kultura e Voskopojës, e cila gjatë shek. XVIII u bë një vatrë e madhe qytetërimi dhe metropol i gadishullit ballkanik, me një Akademi e shtypshkronjë dhe me personalitete si T. Kavalioti, Dh. Haxhiu, G. Voskopojari, veprat diturore, filologjike, teologjike e filozofike të të cilëve objektivisht i ndihmonin shkrimin e njohjes së shqipes. Edhe pse letërsia që u zhvillua në Voskopojë, ishte kryesisht në gjuhën greke, nevoja për t’i vënë gardh islamizmit, bënë të domosdoshme edhe përdorimin e gjuhëve amtare, duke inkurajuar zhvillimin e kulturave kombëtare. Në shkollat e Voskopojës

u përdorën dhe arumanishtja e shqipja për mësimin e greqishtes, kurse në shtypshkronjën e saj u shtypën edhe libra arumanisht.

Veprat e shkrimtarëve dhe ditëtarëve të Voskopojës kanë sjellë disa elemente të ideve të iluminizmit evropian. Më i shquari ndër ta, Teodor Kavaljoti është një erudit i kohës. Sipas dëshmimeve të profesorit gjerman Thunman, vepra e Kavaljotit, që mbeti e pabotuar, në pjesën më të madhe ka trajtuar çështje pothuajse nga të gjitha degët e shkencës filozofike. Në të ndjehet ndikimi i Platonit, Dekartit, Malëbranshit dhe Leibnicit.

Rezultat i ndikimit të islamit dhe të kulturës së pushtuesit, ishte formimi gjatë shek. XVIII i një shkolle poetike, ose i një letërsie të shkruar në gjuhën shqipe, por me alfabetin arab. Autorë të saj si: N. Frakulla, M. Kycyku, S. Naibi, H. Z. Kamberi, Sh. e D. Frashëri, Sheh Mala, e të tjerë, trajtuan në veprat e tyre motive të huajtura nga letërsitë orientale, shkruan mevlude e divane me një gjuhë të mbytur nga orientalizmat, lëvruan lirikën dhe epin religjioz. Kjo shkollë nuk pati jetë të gjatë dhe as ndikim të veçantë në zhvillimet e pastajme letrare. Për të plotësuar kuadrin e zhvillimit kulturor të Shqipërisë në shek. XVI-XVIII duhet shënuar, se pati nga autorë vendës vepra të shquara në fushën të arkitekturës dhe të pikturës ikonografike, ku u dalluan Onufri dhe i biri Nikolla (shek. XVI) dhe K. Shpata-raku e D. Selenica (shek. XVIII), të cilët vazhduan traditën e artit fetar post-bizantin, por jo pa ndikime nga

Rilindja evropiane. Në fushë të artit islam mund të përmenden kryesisht ndërtime të kultit.

Shekulli XIX, shekulli i lëvizjeve nacionale në Ballkan, i gjente shqiptarët pa një traditë të mjaftueshme të zhvillimit shtetëror, gjuhësor e kulturor unitar, me një mendësi individualiste dhe regionaliste, të trashëguar nga psikologjia e bajrakut dhe e fisit, për pasojë me një vetëdije kombëtare të pazhvilluar, por me një shpirt rebelimi spontan. Në këtë situatë historiko-kulturore nisi të merrte jetë një lëvizje e organizuar mendore dhe letrare që mori emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare. Ajo u frymëzua nga idetë e romantizmit nacional dhe të iluminizmit, që u kultivuan në rrethet e inteligjencës shqiptare, e cila jetonte kryesisht në mërgim, në kolonitë e vjetra shqiptare në Itali dhe në ngulimet më të reja në Stamboll, Bukuresht, SHBA, Sofje e Kajro.

Ringjallja nacionale, mbujtja e shqipes si gjuhë e kulturës, organizimi i arsimit kombëtar dhe themelimi i letërsisë kombëtare, në rrafshin kulturor, si dhe krijimi i shtetit të pavarur, në rrafshin politik, këto ishin synimet e kësaj lëvizjeje prej së cilës lindi shkolla e romantizmit shqiptar. Ishte ky një romantizëm tipik ballkanik, i mbujtur me frymën e çlirimit kombëtar, me nostalgjinë e mërgimtarit dhe me patosin retorik të evokimit të mesjetës shqiptare, domethënë të luftërave të Gjergj Kastriotit. Kjo shkollë letrare lëvroi kryesisht poezinë. Heroi i saj ishte njeriu etik, shqiptari luftëtar, e më pak njeriu tragjik. Nga motivet dhe format poetike, ajo ka lidhje të ngushta me traditën folklorike. Gjurmimi i kësaj tradite dhe botimet në fushë të saj (“Rapsodi të një poeme arbëreshe”, më 1866 nga De Rada, “Përmbledhje të këngëve popullore dhe rapsodi të poemave shqiptare”, më 1871 nga Z. Jubani, “Bleta shqiptare” më 1878 nga Th. Mitko, etj.), ishin pjesë e programit kulturor të Rilindjes Kombëtare për afirmimin e identitetit etnokulturor të shqiptarëve.

Dy janë përfaqësuesit më të mëdhenj të romantizmit shqiptar të shek. XIX: J. De Rada (1814-1903), lindur e vdekur në diasporën shqiptare në Itali e shkolluar atje dhe N. Frashëri (1846-199), lindur në Shqipëri, i shkolluar në Zosimea të Janinës, por i mërguar dhe vdekur në Stamboll. I pari është poeti romantik shqiptar i rritur në klimën e romantizmit evropian, i dyti romantiku shqiptar që tret në poezinë e tij ndikimet e poezisë lindore, sidomos persiane, me frymën dhe shpirtin e poezisë së romantizmit perëndimor.


SHKOLLA USHTARAKE "SKËNDERBEJ"

Skënderbegasi Razi Brahimi, personalitet i letrave shqipe

Razi Brahimi ish-kritik, ish-pedagog e dekan në Institutin e Lartë të Arteve, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, qysh në krijimin e saj dhe një nga nxënësit e suksesshëm të Shkollës Ushtarake "Skënderbej".

Razi Brahimi lindi, më 9 maj 1931, në Delvinë dhe nuk është e vështirë që, aty për aty dhe me pak fjalë, të shpjegosh se përse çdo shqiptari, po t'i përmendësh emrin e tij, do t'i ndërmendet menjëherë emërtimi: kritik letrar. Ose dhe e kundërta: kritiku letrar shqiptar të kujton menjëherë Razi Brahimin. Mendoj se kjo ka të bëjë me atë se: Për së pari institucionalisht, ata lindën bashkë... Historia e mendimit estetik shqiptar është e hershme. Ajo njihet personalitete të shquara të artit dhe shkencës që kanë shprehur, aty këtu, nëpër organe të ndryshme shtypi, seriozë për kohën, mendimet e tyre estetike, si: Naim e Sami Frashëri, Fan S. Noli, Faik Konica, Mitat Frashëri, Eqrem Çabej, Kostaq Cipo, Mitrush Kuteli, Skënder Luarasi, Dhimitër Shuteriqi, Nonda Bulka e ndonjë tjetër. Trashëgimia e tyre është një thesar i pamohueshëm dhe shumë i çmuar për letërsinë shqipe, por gjithsesi ato, në më të shumtën e rasteve, mbeten shkrime (për qëllime të ndryshme) me mendime estetike, apo qëndrime kritike në kuadrin e artikujve të publicistikës. Rrallë mund të gjejmë ndonjë shkrim që të quhet kritikë e mirëfilltë profesionale, si për shembull debati "A është poet Lasgush Poradeci?", midis Krist Malokit dhe Kutelit, botuar tek revista "Përpjekja shqiptare" e Branko Merxhanit në vitet '30 të shekullit XX.

Historia si datë lindjeje të "kritikës letrare", si një zhanër më vete, në kuptimin e saj të mirëfilltë në Shqipëri, ashtu si edhe për shumë gjini të tjera të artit si teatri, opera, baleti, kinematografia, ...do të njohë vetëm vitet '50 - '60 të shekullit XX. Në këtë këndvështrim, historia e letërsisë shqipe, do t'i njohë prof. Razi Brahimit kontributin e pamohueshëm si një ndër të parët, në mos i pari, që vendosi në ato mote gurët e themelit të institucionit të kritikës letrare. Kritiku Razi Brahimi dhe kritika jonë letrare janë vërsnikë. Gjithashtu letërsia shqipe, veç librave të shumtë me studime letrare dhe kritikë, do ta njohë Razi Brahimin edhe si poet, tregimtar, novelist dhe romancier, por ajo që ai nuk e "tradhtoi" gjer më sot, mbeti kritika. Këtu mund të ndalemi dhe të perifrazojmë një thënie të vetë kritikut tonë që i provoi të gjitha zhanret e letërsisë: "Kritikët e vërtetë janë verë



e thartuar, domethënë si ajo uthulla që përftohet si e tillë, pasi enkas nuk i është ndërprerë fermentimi verës...". - thotë ai. Si një verë e vjetër e cilësisë më të lartë, e transformuar qëllimshëm në "uthullën" e munguar në sofrën e letërsisë shqiptare, antikonformist si ai, kritiku Razi Brahimi, vazhdon ta mbajë fort stafetën e vendit të parë. Dy esetë e tij të përmbledhura në një libër: "Adresa e poetit Nase Jani" dhe

kompetencën e profesionistit të rrallë çdo vlerë të këtij krijuesi të veçantë... Eseta brilante "Na mungon Migjeni", që na dhuroi së fundmi Razi Brahimi, veç vitalitetit fizik, dëshmon edhe për vitalitetin e mendimit kritik shqiptar, që e mban me të drejtë kritikun tonë, jo vetëm si një gur të çmuar themeli në letërsisë bashkëkohore shqipe, por edhe si mendimtarin më të fuqishëm në raport me aktualitetin.

me sukses në rrugën e shkrimtarëve misionarë shoqërorë, duhet, përveç talentit dhe zotërimit të mjeshtërisë së fjalës artistike, burrëria, për ta thënë hapur dhe pa ekuivokë e konformizëm mendimin dhe për t'i dhënë në dorë shoqërisë, pasqyrën për të parë vetveten lakuriq. I kërkohet shpengim prej censurës së tregut, e cila në vend të orientojë, çorienton si përmbushësh oreksesh të parallinjve dhe të atyre që

● *Historia e mendimit estetik shqiptar është e hershme. Ajo njihet personalitete të shquara të artit dhe shkencës që kanë shprehur, aty këtu, nëpër organe të ndryshme shtypi, seriozë për kohën, mendimet e tyre estetike, si: Naim e Sami Frashëri, Fan S. Noli, Faik Konica, Mitat Frashëri, Eqrem Çabej, Kostaq Cipo, Mitrush Kuteli, Skënder Luarasi, Dhimitër Shuteriqi, Nonda Bulka e ndonjë tjetër. Trashëgimia e tyre është një thesar i pamohueshëm dhe shumë i çmuar për letërsinë shqipe, por gjithsesi ato, në më të shumtën e rasteve, mbeten shkrime (për qëllime të ndryshme) me mendime estetike, apo qëndrime kritike në kuadrin e artikujve të publicistikës.*

"Çmendina", - një roman ndryshe, flasin për vëmendjen e studiuesit të vërtetë që vëzhgon me përgjegjësi atdhetare, fatin e shkrimtarëve seriozë që krijojnë në mërgim. Qëmton dhe evidenton me

Razi Brahimi lindi më 9 maj, dhe kjo datë përkon edhe me Ditën e Fitores mbi fashizmin. Vetëm një intelektual antifashist i lindur, human e trim si ai, mund të thotë troç: "Për të ecur

kanë interes të trullosin lexuesit me eksitantë cilësish të dyshimta e t'u japin vlerë të pamerituar mediokritetit, vulgaritetit e banalitetit, lektisjeve erotike, përfytyrimeve të kllapishme e

fantazmagorike, arratisjeve në sfera spekulimesh pseudo filozofike apo ngujimesh në subjektivizëm të skajshëm individualistësh e egoistësh, të cilët rrihen të zënë vendin e heroit tipik të kohës."

Dosjet e tij, me mijëra fletë të daktilografuara, që shtohen çdo ditë nga i palodhuri Razi Brahimi, janë pasuri e kulturës kombëtare dhe duhet të gjejnë sa më parë dritën e botimit. Me këtë krijimtari të begatë, plot shëndet edhe vital, me shembullin e tij "babai i kritikës shqiptare", jep një mesazh të madh dhe u thotë më të rinjve: "Stafeta nuk dorëzohet. Ajo rrëmbehet. Ejani në garë dhe provojeni ta rrëmbeni! Unë Razi Brahimi s'kam ndërmend ta ndal vrapin..."

Me librin e tij "Vetëvrasje poetësh", duke portretizuar si një mjeshtër që do ta kishin zili edhe kritikët bashkatdhetarë të Pushkinit, Esenin, Majakovskit dhe Fadajevit, për të cilët flitet aty, kritiku ynë Razi Brahimi, bën edhe një radiografi shumë interesante të sistemit shoqëror dhe të "sëmundjeve" të kohës kur jetuan poetët e sipërpërmendur... Me stilin e një mjeshtri që është plakur duke shkruar, me guxim e një intelektual si ai, mendimtarin Razi Brahimi trajton me realizëm mjerimin shpirtëror, degradimin dhe degjenerimin moral tek artisti. Në libër u jepet përgjigje pyetjeve që shkaktuan pendesën, brejtjen e ndërjegjes, krizën psikologjike dhe vetëvrasjen e tyre. Tema këto, krejt të virgjëra për lexuesit shqiptarë. Në fund të parathënies së këtij libri të rrallë, autori ynë thotë: ... "Vetëvrasje poetësh", siç e besoj se do të vërehet prej lexuesve, është një libër i shkruar në kohën kur autori është "me një këmbë në zengji", por mendimet e shfaqura në të mbajnë vullën e një tridhjetëvjeçari që nuk e pranonte vetëvrasjen dhe aspironte e besonte në një rend shoqëror, në të cilin rrethanat bëhen aq njerëzore, sa i sigurojnë hapësirë të lirë jete e zhvillimi çdo individualiteti." Sa për atë që thotë më sipër se: "...autori është 'me një këmbë në zengji'...", duket se kritiku ynë e "ka harruar" atë që Bertold Brehti i shkruante dikur Lion Fojtvaner-it: "E ke për detyrë kombëtare që të rrosh gjatë! Artistët si ty, dinë ta përdorin më së miri pleqërinë e tyre". Këtë "urdhër" të antifashistit të pavdekshëm që shkroi "Arturo Ui"-në, i japin edhe të gjithë krijuesit e Klubit "Drita" në Botë: Të rrosh gjatë Razi Brahimi!..

Kujtim Borici,
Maksim Fejzullai

Djemtë e Gjerbësit ranë për liri



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Fshati Gjerbës i edukoi me ndjenjën patriotike

Ata ishin katër djem nga Gjerbësi, Besim Nesim Alushani, Faik Arshin Flamuraj, Resul Qerim Alushani dhe Sadik Qani Alushani, të cilët ranë, më 17 mars 1943, në luftë me fashistët italianë dhe xhandarmërinë shqiptare në fshatin Sult të rrethit të Gramshit.

Ngjarja e dhimbshme për fshatin Gjerbës të Tomoricës. Të katër ishin djem të rinj, katër partizanë të cilët sapo kishin hyrë në radhët e çetës së parë partizane me tradita luftarake të Skraparit dhe ranë me armë në dorë, të tradhtuar nga strehuesi i shtëpisë, ku bujtën natën e marsit të vitit 1943, pas një aksioni të kryer. Ishin të rinj në moshën 20-22 vjeç, trima dhe të guximshëm, kushërinj midis tyre, por dhe miq e shokë.

U lindën dhe u rritën së bashku, kohën e fëmijërisë e kaluan në Gjerbës, mes varfërisë, por të patriotëve, mes vështirësive të shumta dhe të pak gëzimeve nga jeta. U rritën duke punuar me të rriturit në një ambient shoqëror, ku zotëronte ndjenja atdhetare dhe idetë përparimtare të kohës. E zgjuan më tepër ndjenjën e lartë të atdhedashurisë, të shpresës dhe të lirisë tek të katër të rinjtë ndodhitë luftarake të çetës së Mestan Ujanikut, të shpartallimit të milicëve në Mëlovë, më 31 gusht 1942, dhe të çlirimit të qendrës së Skraparit, Çorovodës, më 5 shtator 1942, ngjarje që bëri jehonë.

Me fillimin e vitit 1942 Besimi dhe Faiku u thirrën për të kryer shërbimin ushtarak të detyrueshëm në Elbasan. Lëvizja partizane në vitin 1942, edhe në Skrapar dhe në Tomoricë kishte filluar aksionet e saj të para. Puna propagandistike e Frontit Nacionalçlirimtar, që të rinjtë ushtarë të dezertonin nga radhët e milicisë fashiste po jepte rezultate. Në muajin dhjetor 1942, Besimit dhe Faikut iu erdhi një letër nga komanda e çetës partizane, ku iu bëhej thirrje të braktisnin radhët e ushtrisë dhe të milicisë fashiste dhe të ktheheshin në Gjerbës, për t'u bashkuar me lëvizjen partizane. Ata u arratisën nga ushtria fashiste dhe morën kontakte me lëvizjen dhe takohen me komandantin e çetës partizane, Xhemal Mestan Ujanikut dhe komisarin Xhevit Struga. Komandës së çetës i kërkuan pranimin e tyre në çetë, por për vështirësitë e çetës dhe të kushteve të dimrit të ashpër, u la rreshtimi i tyre në çetën partizane në fillim të pranverës.

Në Gjerbës të rinjtë kishin një territor të lirë nga okupatorët dhe ambienti ishte tërësisht antifashist. Këtu vepronte çeta territoriale e fshatit dhe pushtetin e ushtronte Këshilli i Frontit Nacionalçlirimtar i fshatit. Të rinjtë u njohën me aktivitetin politik të Ismail Alushanit, i cili, ishte sekretar i rinisë komuniste të Gjerbësit dhe partizan i orëve të para të çetës plakë partizane të Skraparit. Shembulli



i tij kishte frymëzuar mjaft të rinj të fshatit që ishin përfshirë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Në aksionin e parë dhe të fundit

Gjatë dimrit të vitit 1943, nga të rinjtë, Besimi dhe Faiku, u mbajtën kontakte të ngushta me komandën e çetës partizane. Çeta partizane e Skraparit ishte e përqendruar kryesisht në fshatrat Ujanik dhe Gradec. Në mesin e marsit 1943, Besimi dhe Faiku u thirrën në komandën e çetës dhe pranohen partizanë në radhët e saj. Komanda e çetës në ditën e parë iu ngarkoi për detyrë të kryenin një aksion të rëndësishëm dhe të vështirë në zonën e Gramshit.

Detyra ishte të kontrollonin postën Elbasan-Gramsh, të arrestonin dy zyrtarë, bashkëpunëtorë të ngushtë të fashizmit, dhe t'i sillnin ata në komandën e çetës. Në këtë aksion Besimi dhe Faiku u shoqëruan nga Resul Alushani dhe Sadik Alushani, me dijeninë e komandës së çetës partizane.

Aksioni kishte të bënte me kapjen e Riza Kishtës, komandant xhandarmërie në zonën e Gramshit dhe Petrit Shahinin. Ngarkuan Besim Alushanin dhe Faik Flamurajn, të cilët e njihnin mirë terrenin ku do vepronin, pasi kishin qenë ushtarë në këtë zonë. Partizanët e rinj të çetës morën detyrën e parë si partizanë. Komanda e çetës u dha udhëzimet përkatëse për të ruajtur sekretin e detyrës që të kontrollonin postën në linjën Elbasan-Gramsh dhe personat të cilët udhëtonin me këtë linjë dhe të silleshin në çetë bashkë me postën sekrete. Në ditën e dytë partizanët u nisën për të kryer detyrën e ngarkuar.

Më datë 16 mars 1943, në vendin Cerunjë u organizua aksioni. Shoferi ishte italian dhe thirri "Mama mia!". Para autobusit doli Besim Alushani i armatosur, veshur me kapotë ushtarake dhe bëri me shenjë që të ndalonte. Autobusi ndaloi dhe Besimi i armatosur u fut brenda në autobus. Iu tha pasagjerëve: "mos u trembni se me ju nuk kemi punë". Shkoi tek shoferi dhe mori një

zarf që ishte posta zyrtare. Kontrollloi autobusin për personat që kërkonte Riza Kishta dhe Petrit Shahini. Jashtë autobusit qëndronte Faik Flamuraj i armatosur ndërsa pak më sipër, në rrugë qëndronin në gatishmëri Resul Alushani dhe Sadik Alushani. Besim Alushani para se të zbriste nga autobusi u thotë pasagjerëve se kush ka ndonjë ankesë t'i drejtohet çetës partizane të Skraparit.

Pas aksionit të katër partizanët u drejtuan drejt fshatit Sult. Autobusi mbërriti në Gramsh dhe u njoftua xhandarmëria dhe karabinierët italianë.

Besimi, Faiku, Resuli dhe Sadiku, pas aksionit, gjatë rrugës së kthimit, ndaluan në fshatin Sult në shtëpinë e kryeplakut të fshatit V. H. për të kaluar natën. Forcat e xhandarmërisë të Gramshit dhe fashistët italianë, gjatë natës rrethuan shtëpinë ku u strehuan, pasi i zoti i shtëpisë i kishte spiunuar. Në mëngjesin e datës 17 mars 1943 partizanëve iu kërkohet të dorëzoheshin, por luftëtarët nuk pranuan. Ata ishin zënë në befasi me tradhti. Ruajtën qetësinë dhe larguan jashtë shtëpisë njerëzit e familjes. Vetë nuk pranuan të dorëzoheshin. Nisën luftimin duke mos llogaritur jetën e tyre. Në përpjekje për të çarë rrethimin u vranë njeri pas tjetrit. Besim Alushani mbeti i plagosur. Ai u ekzekutua më pas nga xhandarët, pasi nuk kishte pranuar t'i falet jeta.

Për ngjarjen në Sult u njoh i gjithë fshati e më gjerë. Aty u bë luftë. Lajmi se katër partizanë ishin vranë në luftë me fashistët italianë dhe xhandarët u përhap menjëherë në zonë. Banorët e fshatit Sult morën pjesë në varrosjen e partizanëve të vranë. Në Sult për shumë vite vendi ku u varrosën partizanët e quanin "Varri i djemve të Gjerbësit". Në vitin 1986 u organizua zhvarrosja dhe eshtrat e tyre u kthyen në vendlindje, në Gjerbës. Ngjarja bëri bujë në gjithë zonën e Gramshit dhe u fol gjatë për

trimërinë e treguar nga partizanët. Ndërsa autoritetet ushtarake vendore deklaruan se "katër banditë, partizanë, të dërguar nga çeta e Skraparit u rrethuan në një shtëpi në fshatin Sult dhe u vranë nga forcat qeveritare".

Pas rënies heroike...

Komanda e çetës ishte në pritje të rezultatit të aksionit. Pas dy ditësh u informua për masakrën që kishte ndodhur. U vranë katër partizanë të rinj, pas një beteje me xhandarët dhe fashistët italianë në fshatin Sult të Gramshit, të rrethuar e të tradhtuar. Komanda e çetës njoftoi familjarët në Gjerbës.

Akti heroik, për fatin e keq të këtyre partizanëve që dhanë jetën në moshën e rinisë, nuk u vlerësua jo vetëm kur ndodhi, por nuk është vlerësuar dhe për vite të tërë. Në familjet e partizanëve të rënë në Gjerbës shkoi për ngushëllim, në emër të çetës, Xhemal Ujaniku, komandanti i çetës dhe komisar Xhevit Struga. Ata u shprehën se do hakmerreshin.

Mbi masakrën e ndodhur në fshatin Sult nuk u hodh dritë e plotë mbi ngjarjen, që në mars 1943. Pas luftës ndodhën ngjarje të tjera, të papritura dhe të rënda për Tomoricën. Komandanti partizan, patrioti Mestan Ujaniku jo vetëm që u vlerësua për kontributin e tij të shquar atdhetar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, por si pasojë e rrethanave të krijuara, dënohet me burgim të përjetshëm për veprimtari armiqësore. Ai vdiq në burg në mënyrë misterioze në vitin 1948. Edhe komandanti partizan, djali i tij, Xhemal Ujaniku, vëllai i tij Vehepi ish-partizan, të dy oficerë në ushtri, dënohen dhe burgosen. Këta që do të flisnin për masakrën, u vranë, u burgosën dhe u denigruan.

Ismail Qerim Alushani (dëshmor i atdheut), që i kishte frymëzuar të rinjtë për të dalë partizan, në kohën e vrasjes të vëllait të tij, Resulit dhe tre partizanëve, gjendej në zonën e Beratit

në çetën e komanduar nga Mestani. Ai pas çlirimit të vendit, vazhdoi luftimet në Jugosllavi me brigadën ku ishte komandant batalioni. Me përfundimin e luftës emërohet komandant i batalionit të ndjekjes. Ra në kryerjen e detyrës në vitin 1947 në luftë me bandën e Hamit Matjanit në zonën e Elbasanit.

Para shumë vitesh mbi bazën e dëshmimeve u përgatit dosja që partizanët e masakruar në Sult të Gramshit të shpallehin dëshmorë të atdheut. U paraqit në Komitetin Ekzekutiv të Skraparit, me angazhimin e Komitetit të Veteranëve të Skraparit si dhe të Komitetit të Veteranëve të Gramshit etj. U diskutua, por individë nga Gjerbësi dhe Çorovoda, bënë që dosja të mbetej në sirtar.

Qëndrim objektiv dhe atdhetar ka mbajtur në çdo kohë Komiteti i Veteranëve të Rrethit të Gramshit të cilët kanë këmbëngulur vazhdimisht që katër djemtë e vranë nga fashistët dhe xhandarët, në mars 1943, të shpallehin dëshmorë. Pavarësisht qëndrimit dhe mendimit të Komitetit të Veteranëve të Gramshit, dëshmisë të Xhemal Ujanikut, ish-komandantit të çetës partizane, dëshmisë së veteranit Stefan Tavanhuiu etj., akti i Besimit, Faikut, Resulit dhe Sadikut, të cilët dhanë jetën në mars 1943, duke luftuar me fashistët italianë dhe bashkëpunëtorët e tyre, nuk u vlerësua si akt atdhetar. Komiteti i Veteranëve të Skraparit nuk dha dakordësi që partizanët të shpallehin dëshmorë, pasi ishte akoma me mendimin se Mestan dhe Xhemal Ujaniku ishin "armiq të popullit"(!), edhe pse pas viteve '90 statusi i tyre ka ndryshuar dhe janë vlerësuar si figura të shquara të Luftës në Skrapar.

Njohja zyrtare e veprës së tyre ka rëndësi. Kjo do ishte nder për vendlindjen e partizanëve që ranë si heronj në luftë me okupatorin. Ata ishin atdhetarë që historinë e jetës së tyre e shkruan me gjakun e tyre. Për këtë krenohemi.

Mundësi të *shkëlqyera* studimi në *akademitë ushtarake* më të mira në botë.
Tetë bursa të plota studimi, **6** në Akademinë e Marinës në SHBA dhe 2 në Itali, njëra për karabinieri në Modena, tjetra për detari në Livorno.


Gjithçka mbulohet nga shtetet pritëse.

Forcat e Armatosura shqiptare garantojnë *punësim dhe karrierë të sigurt* pas përfundimit të studimeve.

Kriteret dhe afatet i gjeni në linqet e mëposhtme:

<https://bit.ly/3SIJ2Vd>

<https://bit.ly/3FqoyxI>



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES

8 BURSA STUDIMI



NË AKADEMITË
USHTARAKE MË TË
MIRA NË BOTË